



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Ligor Romaçka** më datë **04.07.2024**, Nr. Regj.Them **424**, ka paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kërkesën penale me objekt: Kërkohet nga gjykata marrja e informacionit nga ana e Organit Procedues Struktura e Posaçme Antikorrupsion (SPAK) dhe verifikimi i nevojave të sigurimit personal për shtetasit nën hetim Ligor Romaçka, Idriz Manej, Bledar Berberi dhe Mariglen Topuzi, duke u revokuar masa e sigurimit personal “*Arrest në burg*” apo edhe duke u zëvendësuar masa e sigurimit personal nga “*Arrest në burg*”, në atë të “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.
2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, me vendimin Nr. **424**, datë 11.07.2024, vendosi:
  1. Vazhdimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i Kodit të Proçedurës Penale, caktuar ndaj **personave nën hetim Ligor Romaçka, Idriz Manej, Bledar Berberi, Mariglen Topuzi**, me vendimin Nr.690 datë 01.10.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
  2. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në bashkëpunim me Policinë Gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
  3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmbja e njoftimit të këtij vendimit.

Tiranë më datë 11.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar